



E hënë, 30 qershor 2014

## NJOFTIM PËR MEDIA

Në mbledhjen e datës 30.06.2014 Zyra e Rregulatorit për Energji (ZRRE) ka aprovuar tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, të cilat do të aplikohen nga Furnizuesi Publik nga data 1.07.2014.

Tarifat me pakicë do të rriten për 4.57% për të gjitha nivelet e ndryshme të tarifave dhe për të gjithë konsumatorët e rregulluar. Rritja e tillë paraqet një minimum i cili është i domosdoshëm përfunksionimin normal të sistemit elektro-energetik të Kosovës .

Bazuar në komentet e palëve të interesit dhe diskutimeve publike për ndryshim të strukturës tarifore, anëtarët e Bordit të ZRRE-së nuk kanë arritur në pajtueshmëri për ndryshimin e strukturës tarifore përkëtë vit, që do të thotë se struktura tarifore mbetet e njëjtë.

Për vodosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka realizuar me të licencuarit gjatë periudhës shkurt-maj 2014. Këto dokumente janë:

- Raport Vlerësimi-Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar me datën 15 maj 2014;
- Raporti Përfundimtar- Kalkulimi i Kostos me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
- Raporti Përfundimtar- Kalkulimet e MAR-it të KOSTT SH.A, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
- Raporti Përfundimtar- Kalkulimet e MAR-it të OSSH-së, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
- Përgjigjet ndaj Komenteve të KEDS-it - Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara, i publikuar me datën 24 qershor 2014.
- Raporti përfundimtar -Kalkulimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPEE), i publikuar më datën 24 Qershor 2014.
- Përcaktuesit e faturimit të aprovuara nga ZRRE për vitin Relevant tarifor 2014-2015.

Nga tabela e tarifave me pakicë vërehet se tarifat e konsumatorëve shtëpiak (niveli i tensionit të furnizimit 0.4kV matësi 2 tarifor (2 vlerësh, shtëpiak)) kanë pësuar këto ndryshime:



Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Të miratuarat 2013		Të miratuarat 2014		Diferencia (rritja ne vler. absolute)	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fiksë e konsumatorit	€/konsumator/muaj			2.27		2.37		0.10
		Energjia aktive (P) pér konsum:								
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€c/kWh	Tarifë e Lartë	5.05	3.63	5.28	3.80	0.23	0.17
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	2.54	1.81	2.66	1.89	0.12	0.08
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€c/kWh	Tarifë e Lartë	7.00	5.01	7.32	5.24	0.32	0.23
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	3.51	2.51	3.67	2.62	0.16	0.11
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€c/kWh	Tarifë e Lartë	10.16	7.27	10.62	7.60	0.46	0.33
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	5.07	3.65	5.30	3.82	0.23	0.17

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.

Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me  $\cos(\phi)=0.95$

Niveli (çmimi) i tarifave përcaktohet varësisht nga konsumi i parashikuar për kategori të ndryshme te konsumatorëve duke pasur parasysh se përmes tarifave duhet të mblidhen të hyrat në shumën prej 239,965,097 EURO e cila i mbulon te gjitha kostot e gjenerimit, transmisionit, shpërndarjes dhe furnizimit të Energjisë Elektrike deri tek konsumatorët fundor.

ZRRE këtë vit ka lejuar më pak kosto në krahasim me vitin e kaluar, duke pasur parasysh se kostot e sistemit vitin e kaluar kanë arritur në vlerë prej 242.5 mil euro. Kjo ka ndodhur për shkak të kursimeve gjatë vitit 2012 prej 17.9 milion Euro, furnizuesi publik është lejuar të mbledh vetëm Të Hyrat e Lejuara Maksimale në vlerë prej 224.6 mil. euro.

Pas të gjitha analizave të kryera dokumenteve dhe raporteve të përmendura më lart, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar ndryshimin e tarifave me pakicë për të siguruar mbledhjen e të Hyrave të lejuara Maksimale prej 239,965,097 euro, në bazë të Vendimit për të hyrat Maksimale të Furnizuesit Publik.

Duhet të theksohet se ZRRE është duke analizuar me kujdes trendët e ndryshimit të faktorëve të cilët përcaktojnë çmimin e energjisë elektrike dhe këto tende janë në rritje. Disa prej faktorëve të cilët janë duke ndikuar në rritjen e kostove janë: kostoja operative (pagat mirëmbajtja për shkak të vjetërsisë së aseteve etj), kostot e importit të energjisë elektrike, rritja e tantiemës së thëngjillit, investimet e mëdha kapitale që priten të investohen në sektorin e energjisë elektrike, zvogëlimi i subvencioneve dhe donacioneve dhe ndryshime tjera përfshi edhe ngjarjet dhe rr Ethanat që janë jashtë përgjegjësisë edhe kontrollit të të licencuarve.

Një prej faktorëve të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në nivelin e tarifave është edhe vendimi i marrur nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2012 për rritjen e tantiemës për linjat nga 0.27 €/ton në 3 €/ton, që paraqet një kosto shtesë prej rreth 22 milionë eurosh që duhen mbledhur nga tarifat e energjisë elektrike. Kjo nënkopon që ndikimi i tantiemës në tarifat e energjisë elektrike vazhdon të bëjë presion në ngritjen e tarifave me pakicë për një vlerë prej rreth 8%, kur krahasohet me të Hyrat e Lejuara të vitit 2014.

ZRRE sipas përgjegjësive të saj do të vazhdojë të monitorojë të gjitha kostot e sistemit energjetik në Kosovë për të cilat do të informohet opinion publik në mënyrë transparent.



Në tabelën më poshtë është e paraqitu Struktura e tarifave për të gjithë konsumatorët e rregulluar me pakicë:

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Të miratuara 2013		Të miratuara 2014		Diferenca (rritja ne vlerë absolute)	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0-1	220kV	Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		182.53		190.87		8.34	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		14.44		15.10		0.66	
		Energjia aktive (P)	€c/kWh		2.23		2.33		0.10	
0-2	110kV	Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		91.27		95.44		4.17	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.09	6.09	6.37	6.37	0.28	0.28
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	7.07	2.09	7.39	2.19	0.32	0.10
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Ulët	2.94	1.72	3.07	1.80	0.13	0.08
1	35kV	Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12.07		12.62		0.55	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		6.33	6.33	6.62	6.62	0.29	0.29
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	7.39	3.20	7.73	3.35	0.34	0.15
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Ulët	3.91	2.88	4.09	3.01	0.18	0.13
2	10kV	Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.72	0.72	0.75	0.75	0.03	0.03
		Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.99		5.22		0.23	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.45	5.45	5.70	5.70	0.25	0.25
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	8.28	3.69	8.66	3.86	0.38	0.17
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Ulët	4.46	3.36	4.66	3.51	0.20	0.15
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.72	0.72	0.75	0.75	0.03	0.03
		Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.81		2.94		0.13	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.17	3.17	3.31	3.31	0.14	0.14
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	9.20	5.11	9.62	5.34	0.42	0.23
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Ulët	5.80	4.82	6.06	5.04	0.26	0.22
4	0.4kV Kategoria II	Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.72	0.72	0.75	0.75	0.03	0.03
		Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.18		3.33		0.15	
		Energjia aktive (P)	€c/kWh	Tarifë e vetme	11.33	7.33	11.85	7.66	0.52	0.33
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	13.64	8.94	14.26	9.35	0.62	0.41
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Ulët	6.82	4.46	7.13	4.66	0.31	0.20
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.27		2.37		0.10	
		Energjia aktive (P) për konsum:								
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€c/kWh	Tarifë e Lartë	5.05	3.63	5.28	3.80	0.23	0.17
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€c/kWh	Tarifë e Ulët	2.54	1.81	2.66	1.89	0.12	0.08
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€c/kWh	Tarifë e Lartë	7.00	5.01	7.32	5.24	0.32	0.23
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€c/kWh	Tarifë e Ulët	3.51	2.51	3.67	2.62	0.16	0.11
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€c/kWh	Tarifë e Lartë	10.16	7.27	10.62	7.60	0.46	0.33
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€c/kWh	Tarifë e Ulët	5.07	3.65	5.30	3.82	0.23	0.17
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.27		2.37		0.10	
		Energjia aktive (P) për konsum:								
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€c/kWh	Tarifë e vetme	4.51	3.22	4.72	3.37	0.21	0.15
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€c/kWh	Tarifë e vetme	6.24	4.46	6.53	4.66	0.29	0.20
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€c/kWh	Tarifë e vetme	9.05	6.49	9.46	6.79	0.41	0.30
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:								
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		23.41		24.48		1.07	
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		42.37		44.31		1.94	
		>600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		71.40		74.66		3.26	
8	Ndriçim publik	Tarifa fiks e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.18		3.33		0.15	
		Energjia aktive (P) për konsum:	€c/kWh	Tarifë e vetme	9.17		9.59		0.42	

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.

Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me  $\cos(\phi)=0.95$